

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **SPITALI I PËRGJITHSHEM - GJAKOVË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **70020-25-3241-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>ALLTON SH.P.K.</b>
NUI	<b>811923657</b>
Adresa	<b>Rruga Muharrem Fejza nr 4</b>
Vendi	<b>Prishtine</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>048 663 666</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Allton Shpk</b>
Adresa elektronike	<b>allton.shpk@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>10.06.2025</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

#### **Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit**

**1. Njoftimi për kontrate i datës 18.04.2025**

**2. Dosja e tenderit e datës 18.04.2025**

**3. Dosja e tenderit e Amandamentuar 22.05.2025**

**4. Hapja e tenderit 11.06.2025**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☐

Jo ☒

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Kërkesa për Rishqyrtim e Dates 04.06.2025**

**Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e dates 09.06.2025**

#### **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

## **Shkeljet e LPP-se nga ana e Autoritetit Kontraktues:**

Neni 1 – Qëllimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminim

Neni 27 Dosja e tenderit

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

### **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

"Pas refuzimit të kërkesës sonë për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues – Spitali i Përgjithshëm Gjakovë, duke iu referuar aktivitetit të prokurimit me titull: 'Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit', me numër të prokurimit 70020-25-3241-2-1-1, ushtrojmë këtë:

## ***ANKESË***

### ***Pretendimi nr.1***

Në Dosjen e Tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull "*Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit*", me nr. të prokurimit 70020-25-3241-2-1-1, është përcaktuar se: "*Menaxheri duhet të ketë diplomë Bachelor ose Master dhe minimum 3 vite përvojë pune*", por në të njëjtën kohë thuhet se "*në analizën financiare nuk duhet të përfshihet paga e menaxherit*".

Kjo përbën një kontradiktë të qartë, pasi pagat e stafit menaxhues janë pjesë e shpenzimeve reale të një operatori ekonomik. Përgjashtimi i pagës së menaxherit nga analiza financiare nuk pasqyron realisht koston për ofrimin e shërbimeve dhe çon në deformim të çmimit për njësi, duke shtrembëruar konkurrencën e drejtë dhe barazinë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye, i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit me kërkesë që të vlerësojë ligjshmërinë e këtij kriteri, duke marrë në konsideratë se menaxheri është pozitë e kërkuar në mënyrë të detyrueshme për realizimin e kontratës dhe si i tillë, kostoja e tij duhet të

përfshihet në analizën financiare.

Në rastin konkret, kërkesa që paga e menaxherit të mos përfshihet në analizën financiare është, sipas mendimit tonë, në kundërshtim me parimin e ofertës së përgjegjshme dhe barazisë ndërmjet operatorëve, si dhe nuk reflekton llogarinë reale të kostove të kontratës. Operatorët ekonomikë nuk mund të detyrohen të subvencionojnë kostot e stafit të kërkuar me mjete të veta.

Prandaj kërkojmë nga OSHP që të urdhërojë Autoritetin Kontraktues të përmirësojë kriterin në fjalë, në mënyrë që paga e menaxherit të përfshihet si element i domosdoshëm në analizën financiare, duke siguruar kështu respektimin e parimeve të barazisë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë në procedurat e prokurimit publik. Kërkojmë nga OSHP që ta shqyrtojë dhe ta miratojë këtë:

## ***V E N D I M***

**APROVOHET** si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik : “**Allton**” SH.P.K ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: "Pastrimi i Hapësirave të Brendshme të Spitalit" me nr. te prokurimit **70020-25-3241-2-1-1**, te iniciuar nga Spitali i Përgjithshem Gjakove.

**URDHËROJË** Autoritetin Kontraktues të korrigjojë Dosjen e Tenderit, në mënyrë që të eliminohen mospërputhjet dhe kërkesat kontradiktore.

### **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Nuk ka**

### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.